



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË  
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS PËR VITIN  
2021

**Prishtinë, qershor 2022**

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpenzimet e MDK-ve në vlerë prej 1,813,379€, nuk ishin regjistruar në SIMFK deri në fund të vitit fiskal 2021; dhe
- B2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale në vlerë prej 50,275€ ishin të nënvlerësuar si rezultat i mosregjistrimit në regjistrat përkatës të pasurive.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### Baza për konkluzion

- A1 Vonesat në pagesën e faturave kishin shkaktuar kosto shtesë prej 8,356€ në emër të procedurës kontestimore/ përmbarimore, interesit dhe ekspertit financiar;
- B3 Gjatë vitit 2021 nga MDK-të kishte tejkalim të limiteve bankare dhe mjetet nuk ishin transferuar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës siç e parasheh udhëzimi administrativ; dhe
- B4 Shpenzimet për periudhën qershor-gusht 2021 në vlerë 37,866€ nuk ishin aprovuar dhe regjistruar, pasi që nuk ishin në përputhje me Urdhëresën e MPJ-ZSP/100-15 për racionalizimin e shpenzimeve.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### Çështje tjetër

- 1 Shpenzimet në vlerë 157,279€ nga kategoria e investimeve kapitale lidhur me një kontratë nuk janë auditur për shkak se ishin në procedurë hetimore.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja e MPJD-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme

dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Ministria ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 22,659,798€ me një rënie prej 15% në krahasim me vitin 2020.

Fushat me probleme të theksuara të shpenzimit kanë të bëjnë me menaxhimin e financave që ndërlidhen me mos regjistrimin e plotë të shpenzimeve të MDK-ve në SIMFK, raportimin me vonesë të aktiviteteve financiar nga ana e MDK-ve, menaxhimi jo efikas të qirave në misione diplomatike dhe tejkalim të shpenzimeve duke anashkaluar aprovimet që kërkohen me rregullat e brendshme.

Po ashtu, mangësi kishte edhe në faktin që nuk ishin respektuar kriteret për rastet kur ka tejkalim të bilancit bankar për kthimin e mjeteve, kishte vonesa në mbyllje të avanseve, dhe klasifikim jo adekuat të shpenzimeve. Me tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet dhe sistemi e-Pasuria nuk ishte përdorur, përfshirë edhe mos-harmonizimin e regjistrave dhe mos vlerësim të pasurive. Mangësi janë identifikuar edhe në Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, një (1) pjesërisht i përsëritur dhe shtatë (7) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja B1 - Mos regjistrim i plotë i shpenzimeve të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore

#### Gjetja

Neni 20 i Rregullores së MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor të Organizatave Buxhetore, përcakton se "Avancet e dhëna si para të gatshme si para të imëta, udhëtime zyrtare dhe /paratë e dhëna në dorë për ambasadat dhe shpenzimet e pa regjistruara nga llogaritë e ambasadave duhet të mbyllën (arsyetohen) në mënyrë që të paraqiten si shpenzime në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare të organizatës buxhetore". Po ashtu neni 12 përkatësisht paragrafi 12.5 i LMFPP ndër tjera përcakton: "Për organizatën buxhetore ose agjencinë autonome ekzekutive, ZKF është i autorizuar dhe përgjegjës që të sigurojë që të gjitha transaksionet të regjistrohen në Regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit; të sigurojë që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga organizata buxhetore të dorëzohen menjëherë për pagim përmes sistemit të thesarit; si dhe të siguroj mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve të raportimit buxhetor nga ana e organizatës buxhetore".

Në vitin 2021 gjendja e parave të gatshme dhe avanceve të hapura në MPJD përfshirë Misionet Diplomatike dhe Konsullore (MDK) ishte në vlerë prej 2,203,492€. Prej tyre 1,986,538€ kishin të bënin me mos regjistrimin e shpenzimeve, rimbursimeve dhe të hyra konsullore në MDK kurse pjesa prej 216,954€ ishte petty-cash i MPJD-së.

Sipas shpalosjeve në PFV deri në fund të vitit 2021 shuma prej 1,813,379€ ishin shpenzime të raportuara nga MDK-të dhe të pa regjistruara në SIMFK. Shpenzimet e paregjistruara në SIMFK nga ana e Ministrisë po rriten nga viti në vit e kur dihet fakti që një pjesë e tyre janë edhe të viteve paraprake kjo do të mbetet sfidë edhe për vitin në vijim.

Shkaqet e mos regjistrimit të shpenzimeve të raportuara ishin të ndryshme si: menaxhimi i dobët i tyre nga ministria, ndërprerja e praktikës të viteve paraprake nga Thesari për zgjatje të afatit për mbylljen e shpenzimeve të MDK-ve, gabimet teknike në ndarjen e mjeteve nga MFPT në kodin funksional joadekuat, lëvizja e zyrtarëve financiar nëpër misione diplomatike si dhe pamjaftueshmëria e kontrollit të brendshëm të zyra e financave.

#### Ndikimi

Mos regjistrimi i të gjitha shpenzimeve të MDK-ve në SIMFK ndikon që vlera e shpenzimeve e paraqitur në PFV të jetë e nënvlerësuar.

#### Rekomandimi B1

Ministrja duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet e raportuara nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore regjistrohen në SIMFK sapo të pranohen nga zyrtarët përgjegjës të MDK-ve dhe të njëjtat raportohen në fund të vitit në PFV si shpenzime të Ministrisë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



**Çështja B2 - Nënvlërim i pasurive kapitale dhe jokatiale****Gjetja**

Neni 6 pika 1 dhe 3 e rregullores MF nr.02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jofinanciare përcakton që "çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Nga mostrat e testuara kemi identifikuar se:

- Pasuritë kapitale dhe jokatiale të blera nga ana e MDK-ve në vlerë prej 37,119€ nuk ishin evidentuar në regjistrat përkatës të pasurive. Po ashtu, bazuar nga analiza e raporteve mujore të pesë MDK-ve tjera vërehet që inventari dhe paisjet tjera të blera në vlerë 13,156€ nuk ishin regjistruar si pasuri; dhe
- Tetë (8) mostra për pasuri jo kapitale në vlerë prej 2,256€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria si rezultat i mos aplikimit të tij, por që të njëjtat ishin evidentuar në një regjistër në excel. Megjithatë, edhe ky regjistër i pasurisë jokatiale i mbajtur në excel nuk ishte i plotë pasi që paisje dhe inventar i blerë nga MDK-të nuk ishte evidentuar plotësisht.

Mosregjistrimi i plotë i pasurive ka ndodhur pasi që zyrtari i pasurisë, për shkakë shëndetësore gjatë tërë vitit 2021 ka qenë në pushim pa pagesë dhe pushim mjekësor dhe nuk ka mundur të angazhohet fare. Në fund të vitit Ministria e ka angazhuar përkohësisht një zyrtar të brendshëm për regjistrimin e pasurive, por i cili nuk kishte arritur të evidentoj të gjithë pasurinë.

**Ndikimi**

Mos regjistrimi i plotë i pasurisë dhe mosfunksionimi sistemit e-pasuria, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive. Gjithashtu kjo ndikon që informatat e prezantuara në PFV, të jenë jo të plota dhe jo të sakta.

**Rekomandimi B2**

Ministrja duhet të ndërmerr veprime konkrete në kohën e duhur për angazhimin e stafit për të mbuluar boshllëqet e krijuara në mënyrë që të mos shkaktohen pengesa në operim gjatë evidentimit të pasurive. Po ashtu, duhet të funksionalizohet sistemi e-pasuria dhe të gjitha pasuritë nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Pagesa nga Thesari dhe kostot e procedurave përbarimore

#### Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Faturat e viteve 2018-2021 (23 fatura) në vlerë prej 33,141€ nuk ishin paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin deri në mbi 3 vite. Thesari sipas vendimit përbarimor kishte ekzekutuar pagesën në vlerë prej 41,496€ nga buxheti i Ministrisë. Prej tyre 33,141€ ishte borxhi kryesor kurse 8,356€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës kontestimore/përbarimore, interesit dhe ekspertit financiar.

Mungesa e një sistemi të pranimit të faturave dhe pranimi i tyre nga departamentet e ndryshme ka qenë shkaktar i mospagesës së tyre.

#### Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave në afatin e përcaktuar kanë ndikuar që Ministria të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përbarimore.

#### Rekomandimi A1

Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit 30 ditor nga pranimi i faturës ose kërkesës për pagesë, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë si pasojë e pagesave me procedura përbarimore apo gjyqësore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B3 - Shpenzime të paaprovuara dhe tejkalim i limiteve të lejuara****Gjetja**

Urdhëresa MPJ-ZSP/100-15 për racionalizimin e shpenzimeve në MDK sqaron se cilat shpenzime lejohen dhe cilat kërkojnë aprovim paraprak nga Sekretari i Përgjithshëm.

MDK në Berlin, kishte raportuar shpenzimet për periudhën qershor deri në gusht, 2021 në vlerë 141,932€. Pas analizimit të tyre nga zyrtarët shpenzues në MPJD ishte identifikuar dhe raportuar në nivelet menaxheriale se shpenzimet prej 37,866€ nuk ishin në përputhje me Urdhëresën e lartëcekur. Tejkalimet kishin të bënin me shpenzimet e drekave<sup>[1]</sup>, përderisa blerja e mobiljeve dhe blerjet tjera që kërkonin aprovim ishin bërë pa aprovim nga Sekretari i Përgjithshëm.

Po ashtu, MDK në Berlin në muajin gusht kishte bërë pagesë për biletë të udhëtimit në vlerë prej 285€ për një person nga shoqata ekonomike gjermano-kosovare. Për këtë shpenzim nuk kishte aprovim nga sekretari.

Ministrja e MPJD-së më datë 21 maj 2021 kishte nxjerr vendimin për lirim nga detyra të shefit të misionit në Berlin, pas marrjes së dekretit nga Presidentja. Në bazë të vendimit shefi i misionit duhej të kthehej në Kosovë me 30 gusht 2021. Pas këtij vendimi ishin bërë këto tejkalime të shpenzimeve dhe nuk ishin marrë aprovime paraprake siç kërkohet.

**Ndikimi**

Tejkalimet përtej limiteve dhe shpenzimet e paaprovuara përveç që janë në kundërshtim me Urdhëresën mund të ndikojnë në dëmtimin e buxhetit të Ministrisë.

**Rekomandimi B3**

Ministrja duhet të themeloj një komision për të analizuar në detaje shpenzimet e ndodhura duke rezultuar me një raport të tyre. Për shpenzimet të cilat nuk kanë asnjë justifikim dhe nuk ishin aprovuar duhet të ndërmerren veprime për kthimin e mjeteve në buxhetin e Ministrisë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Tejkalim i limiteve bankare nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore****Gjetja**

Neni 13 Bilanci bankar i tejkshuar i Udhëzimi Administrativ nr. 05/2009 për procedurat e pagesës dhe shërbimet bankare për Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës përcakton: Në rast se misioni grumbullon të hyra që e tejshkojnë për 25% bilancin maksimal të aprovuar bankar që duhet të mirëmbahet, Thesari do të përgatis Formën për Transfer të Jashtëm dhe t'ia dorëzoj Kontraktorit për të transferuar shumën shtesë të mjeteve nga llogaria bankare e misionit në Fondin e Konsoliduar të Kosovës (FKK) në Bankën Qendrore të Kosovës. Thesari e njofton MPJ-në secilën herë që zë vend një transfer i tillë.

Edhe në vitin 2021 gjatë procesit të auditimit kemi identifikuar se bilanci bankar lidhur me mbajtjen e mjeteve nëpër llogari të MDK-ve ishte tejkaluar mbi limitin e përcaktuar. Ne kemi testuar disa MDK për muajin janar dhe qershor si: Konsullata në Shtutgart, Mynhen, Dyseldorf dhe Gjenevë dhe kemi vërejtur se limiti për mbajtjen e mjeteve financiare ishte tejkaluar mbi normën e përcaktuar me udhëzimin administrativ, dhe mjetet nuk ishin transferuar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

Sipas Thesarit tejkalimet ishin si në vijim: Konsullta-Shtutgart në janar kishte tejkalim për 114,938€, kurse në qershor për 189,254€, Konsullta-Mynhen në janar kishte tejkalim për 79,918€, kurse në qershor për 190,906€, Konsullta - Dyseldorf në janar kishte tejkalim për 180,060€, kurse në qershor për 116,765€, dhe Konsullta-Gjenevë në janar kishte tejkalim për 67,246€ kurse në qershor për 111,413€.

Kjo dukuri kishte ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes jo të mjaftueshme të shefave të MDK-ve dhe menaxhmentit të ministrisë.

**Ndikimi**

Mbajtja e mjeteve mbi limitin e lejuar bankar përveç që është në kundërshtim me udhëzimin administrative të MPJD-së mund të ndikon që të rriten shpenzimet nëpër MDK.

**Rekomandimi B4**

Ministrja duhet të rrisë nivelin e mbikëqyrjes ndaj MDK-ve për të siguruar që kur ka tejkalim të limiteve të lejuara mjetet të transferohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në mënyrë që të evitohen potencialisht shpenzimet e paarsyetuara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2021 ishte 18,875,073€, prej tyre ishin shpenzuar 14,749,811€. Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime të qirasë për Misionet Diplomatike dhe Konsullore, furnizime për zyre, shërbime të ndryshme shëndetësore, shërbime kontraktuese tjera etj.

#### Çështja A2 - Shërbime pa procedura të prokurimit

##### Gjetja

Neni 21 pika 2 e Rregullës Financiare 01/2013 thekson se shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim janë: pagat shpenzimet e paguar me paratë e imta, avangat për udhëtime, komunalit, subvencionet dhe transferet dhe transaksionet ndërdepartamentale.

MPJD me qëllim të informimit të opinionit publik dhe reklamimit të institucionit kishte lidhur marrëveshje për shërbime me një operator ekonomik (media-portal) pa zhvilluar ndonjë procedurë të prokurimit. Marrëveshja ishte nënshkruar në afat prej pesë muaj (nga data 20.01.2021 deri më 19.06.2021), dhe për këtë marrëveshje ishin kryer pagesa në vlerë prej 5,000€. Këto blerje nuk bëjnë pjesë të shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim.

Nuk kishte arsye të përjashtimit të procedurave të prokurimit për këtë marrëveshje, por arsyetimi i Ministrisë ishte se ata kishin nevojë për publikime në ndonjë media-portal.

##### Ndikimi

Nënshkrimi i marrëveshjes pa procedurë të prokurimit, përveç anashkalimit të rregullave të prokurimit ndikon edhe në mungesë të konkurrencës e që rrjedhimisht mund të rrezikoj që ministria mos të përfitojë vlerën për paratë e shpenzuar.

##### Rekomandimi A2

Ministrja duhet të sigurojë se për të gjitha shpenzimet të cilat nuk janë të përjashtuara nga prokurimi sipas rregullave në fuqi të zhvillohet një proces i prokurimit. Të gjitha marrëveshjet/kontratat që nënshkruhen duhet të jenë produkt i një procesi që siguron konkurrencë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A3 - Menaxhimi jo efikas i banesave të marra me qera në MDK****Gjetja**

Nenit 4 pika 3 e Udhëzimit Administrativ (UA) 01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e UA nr. 03/2012 për Shpenzime personale dhe operacionale në Misione Diplommatike përcakton se: "Përgjegjësia për menaxhimin e kontratës së banimit është e anëtarit të personelit të misionit i cili e shfrytëzon atë objekt banimi". Ne identifikuam se:

- Konsullata në Strasburg kishte paguar qiranë deri në muajin maj 2021 për banesën e cila kishte qenë në shfrytëzim të ish zëvendës konsullit i cili e kishte përfunduar mandatin në dhjetor 2020. Vlera e këtyre pagesave ishte 7,569€ (shpenzimet e qirasë ishin 6,241€ dhe shpenzimet e kaucionit 1,328€). Kërkesa për ndërprerjen e kontratës së qirasë ishte bërë në muajin prill 2021; dhe
- Me vendim të gjykatës në Francë, Ambasada e Kosovës në muajin shkurt 2021 kishte bërë pagesën e qirasë në vlerë 13,507€, për banesë të ish konsullit në Paris. Ambasada nuk kishte kryer pagesën e qirasë në plotëni si dhe nuk kishte marrë parasyshtë ndryshimin e çmimit sipas Entit të Statistikave që bënë rivlerësimin e çmimit. Për shkak të vonesave në pagesën e obligimeve vlera prej 2,998€ ishte diferenca e qirasë që ishte vlerësuar nga Enti i Statistikave, shpenzimet gjyqësore dhe penalet.

Sipas zyrtareve të MDK-së, pagesa e qirasë në Strasburg ishte bërë për ruajtjen e saj për të emëruarit e rinj, megjithatë askush nga diplomatët e rinj nuk kishte pranuar të akomodohej në këtë banesë, ndërsa sa i përket pagesës për banesën në Paris arsyeja ka qenë se pagesat ishin bërë vetëm për qiranë bazë, edhe pse në bazë të e-mailave të shkëmbyera nga ish konsulli drejtuar MPJD shihet se ishin bërë përpjekje të vazhdueshme për pagesë, mirëpo nuk ishte paguar kjo diferencë ku në fillim shumica e borxhit ishte më e vogël mirëpo për shkak të vonesave ishin aplikuar edhe penalet.

**Ndikimi**

Mbajtja e objekteve me qira pa u shfrytëzuar, vonesat në pagesa dhe shpenzimet shtesë (shpenzimet e kaucionit, të gjykatave dhe penalet) ndikojnë në rritjen e shpenzimeve dhe dëmtim të buxhetit të ministrisë.

**Rekomandimi A3**

Ministrja duhet të sigurojë përmes shefave të MDK-ve menaxhim efikas të objekteve të marra me qira me qëllim të ruajtjes së parasë publike. Në rastet e përfundimit të mandatit të stafit të MDK-ve duhet informuar me kohë agjencionet përkatëse për ndërprerjen e kontratës. Po ashtu, mirëmbajtja e duhur e objekteve të marra me qira do të krijonte mundësinë që vlera e kaucionit në përfundim të kontratës t'i kthehet buxhetit të Ambasadës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B5 - Mos raportim lidhur me përdorimin e automjeteve zyrtare nga MDK-të****Gjetja**

Neni 12 pika 2 e Udhëzimit Administrativ 04/12 për përdorim të automjeteve zyrtare për MDK përcakton se: "zyrtari përgjegjës për automjetet, i caktuar nga shefi i misionit diplomatik apo konsullorë harton raportin me shifra për shpenzimet mujore, të plotësuar për të gjitha automjetet e Misionit, duke përfshirë raportin për secilin automjet dhe i njëjti i raporton Divizionit të Transportit/ Logjistikes në MPJ".

Edhe këtë vit kemi identifikuar se rreth gjysma e MDK-të nuk kishin raportuar fare në Divizionin e transportit-logjistikës. Sipas informatave të pranura nga ky Divizion, prej 44 MDK-ve që ishin të obliguara të raportojnë 21 prej tyre nuk kishin raportuar, 10 kanë raportuar në mënyrë jo të rregullt dhe 13 kishin raportuar. Mungesa e raporteve krijon paqartësi nëse automjetet janë duke u shfrytëzuar vetëm për qëllimet e MDK-së.

Mos raportimi kishte rrjedhur si rezultat i neglizhencës së personave përgjegjës nga ana e MDK-ve, përkundër kërkesave të vazhdueshme nga ministria për të raportuar me kohë.

**Ndikimi**

Mos raportimi mujor për automjetet e MDK-ve, mund të ndikojë që automjetet zyrtare të mos përdoren për qëllime të duhura dhe kjo mund të shpie deri të keqpërdorimi i tyre.

**Rekomandimi B5**

Ministrja duhet të siguroj përmes shefave të MDK-ve që mbajtja e evidencave të bëhet për secilin automjet zyrtar dhe përdorimi i tyre të jetë në përputhje me objektivat e MDK-së. Po ashtu, raportet mujore të dërgohen në divizionin përkatës sipas kërkesave të rregullores në fuqi.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B6 - Vonesa në raportim të shpenzimeve nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore****Gjetja**

Neni 17 i Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 01/2018, për plotësim dhe ndryshimin e UA nr. 03/2012 për shpenzimet personale dhe operacionale në MDK të Republikës së Kosovës, në lidhje me raportin mujor të shpenzimeve përcakton se të gjitha shpenzimet pasqyrohen në raportin mujor financiar të MDK-së, i cili i raportohet deri me datën 15 të muajit vijues në departamentin për buxhet dhe financa në ministri. MDK-të janë të obliguara të respektojnë Rregullën financiare 01/2013 gjatë përgatitjes së raportit vjetor.

Ne analizuam raportet mujore të nëntë (9) MDK-ve për të verifikuar nëse kishte vonesa në raportim. Nga kjo analizë vërehet se kishte vonesa në raportim nga 5 ditë e deri në 3 muaj. Kjo dukuri ishte raportuar edhe viteve paraprake, dhe gjendja pothuajse është e njëjtë.

Mos raportimi kishte rrjedhur si rezultat i neglizhencës së personave përgjegjës nga ana e MDK-ve, dhe mos aplikimit të ndonjë mase administrative nga ana e menaxhmentit të Ministrisë.

**Ndikimi** Vonesat në raportimin e shpenzimeve nga MDK-të ndikojnë në vonesa në regjistrimin e shpenzimeve në SIMFK dhe rrjedhimisht një pjesë e shpenzimeve ka mbetur e pa përfshirë në PFV.

**Rekomandimi B6** Ministrja duhet të siguroj përmes shefave të MDK-ve që raportimi i shpenzimeve nga MDK-të të bëhet në kohë të përcaktuar në mënyrë që MPJD të mund të bëjë regjistrimin e shpenzimeve në SIMFK në kohën e duhur.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C1 - Mos mbyllja e avanceve me kohë**

**Gjetja** Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 2004/07 për Udhëtime Zyrtare, mjetet të cilat merren si avanc për udhëtim zyrtar duhet të arsyetohen në një afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi.

Ne kemi identifikuar se avanci për udhëtime zyrtare i hapur në vlerë prej 6,015€ në vitin 2017 nga Ish Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, ishte mbyllur në vitin 2021. Vonesa ishte mbi 3 vite.

Shkak i mos mbylljes së avanceve ishte mos kthimi i mjeteve me kohë nga zyrtarët.

**Ndikimi** Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve dhe mos-mbyllja e avanceve me kohë, mund të ndikojë që paratë publike të keqpërdoren dhe të mos arrihen qëllimet e synuara.

**Rekomandimi C1** Ministrja duhet të ndërmerr masa konkrete në mënyrë që të gjitha avancet të mbyllen në kohën e duhur duke i respektuar rregulloret në fuqi.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,253,400€, prej tyre ishin shpenzuar 287,517€. Ato kanë të bëjnë me pajisje të teknologjisë informative, ndërtesat e administratës afariste dhe softuer.

### Çështja B7 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

#### Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Ne identifikuam se:

- Shpenzimet për furnizim me inventar për zyre në vlerë 6,300€ (karrige lëvizëse me vlerë për njësi 210€) ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale edhe pse për nga natyra dhe vlera këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime; dhe
- Shpenzimet për furnizim dhe montim i dyerve lëvizëse me sensor në ndërtesën e MPJD-së në vlerë 4,550€ (dyert me vlerë 2,275) ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime edhe pse për nga natyra dhe vlera këto shpenzime i takojnë kategorisë investime kapitale.

Kjo kishte ndodhur për shkak se këto mjete ishin buxhetuar gabimisht në kategorinë e investimeve kapitale nga Ministria, në kuadër të projekteve për blerje të mobiljeve, kurse blerja e dyerve ishte emergjente për shkak të rritjes së sigurisë nga Covid-19.

#### Ndikimi

Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, rezultonë me raportimin apo klasifikimi jo të saktë të të dhënave në pasqyra financiare, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

#### Rekomandimi B7

Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve në PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 2,801,520€, pasurive jokapitale është 1,502,364€, si dhe e stoqeve 178,154€.

#### Çështja A4 - Mos-harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrin e pasurive

##### Gjetja

Neni 18 pika 1 dhe neni 19 pika 4.3 i Rregullës MF – nr. 02/2013-për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore thekson se “Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare dhe është përgjegjësi e komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare të bëjë krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”.

Komisioni për inventarizim, kishte bërë inventarizimin e pasurive me kohë, mirëpo nuk ishte bërë harmonizimi në mes gjendjes së konstatuar nga inventarizimi me regjistrat përkatës të pasurive. Po ashtu, vlen të ceket se MDK si në Australi, Washington DC, Bern, Danimark dhe Tajland, nuk kanë kryer fare inventarizimin dhe nuk kanë raportuar për gjendjen e pasurive për vitin 2021. MPJD për këto misione kishte marr për bazë vlerën e pasurive të vitit paraprak 2020 për ti prezantuar në PFV.

Harmonizimi nuk është kryer për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurisë si dhe mos funksionimit të sistemit E-pasuria.

##### Ndikimi

Harmonizimi i regjistrit të pasurive me inventarizim do të ndikonte direkt në identifikimin e pasurive të pa regjistruara dhe pasurive që mungojnë duke mundësuar azhurnimin e regjistrit me informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

##### Rekomandimi A4

Ministrja duhet të sigurojë se raporti i harmonizimit të pasurisë bëhet për të gjitha MDK-të dhe se pas përgatitjes së këtij raporti nga komisioni duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantim i pasurive në PFV të jetë i saktë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.4 Detyrimet e papaguara

Sipas PFV obligimet e papaguara në fund të vitit 2021 ishin në vlerë prej 253,306€. Këto obligime janë bartur për tu paguar në vitin 2022.

#### Çështja A5 - Mos protokolimi dhe mungesa e librit të faturave

**Gjetja** Neni 24 pika 1.3 e Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike thekson që fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave, duke i zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit.

Nga pagesat e testuara kemi identifikuar se faturat nuk ishin protokolluar e as evidentuar në librin e faturave. Faturat në Ministri pranoheshin nga departamenti për buxhet dhe financa, departamenti i prokurimit dhe menaxherët e kontratave.

Ministria nuk i ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për pranimin e faturave, sipas rregullave financiare për shpenzimin e parasë publike.

**Ndikimi** Mos protokollimi i faturave dhe mos evidentimi në librin e faturave të pranuar rrit rrezikun që të mos raportohen detyrimet në mënyrë të saktë, të shkaktohen vonesa në pagesën e tyre, madje edhe të humbin fare.

**Rekomandimi A5** Ministrja duhet të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit duke përcaktuar zyrtarin përkatës për protokolimin e faturave dhe evidentimin në librin e faturave sipas rregullës financiare.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) operon me katër anëtar – dy Drejtor të NjAB-së dhe dy auditor, ku gjatë viti 2021 ishte angazhuar edhe një zyrtar i MPJD. Në Planin Vjetor të Auditimit, ishin planifikuar shtatë (7) auditime të rregullta, ku katër prej tyre janë realizuar. Pastaj me kërkesë të menaxhmentit është kërkuar të kryhen katër auditime shtesë e ku tre prej tyre janë realizuar. Komiteti i auditimit ka mbajtur dy (2) takime gjatë vitit 2021, për shkak të situatës së pandemisë.

#### Çështja A6 - Mangësi në Njësinë e Auditimit të Brendshëm

##### Gjetja

Neni 22 pika 2 i Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike thekson se “Auditorët e njësisë së auditimit të brendshëm duhet të kenë kualifikimet si në vijim çertifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose çertifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave”. Neni 23 pika 1.2 e po të njëjtit ligj thekson se “Përgjegjësi e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për funksionimin e auditimit të brendshëm është të miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm kurse neni 25 pika 3.3. thekson se “Obligimet e drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorëve të brendshëm janë të përgatis dhe dorëzoj planin strategjik dhe planin vjetor për rishikim dhe miratim tek udhëheqësi i subjektit të sektorit publik”. Ne identifikuam se:

- Me datë 07.04.2021 menaxhmenti kishte nxjerr vendim që Zyrtari i prokurimit të transferohet në pozitën zyrtar i auditimit të brendshëm në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh me pagesë dhe kompetenca të plota edhe pse nuk ishte i çertifikuar; dhe
- Plani vjetor i auditimit për vitin 2021 ishte përgatitur dhe dorëzuar mirëpo nuk ishte aprovuar e as refuzuar nga ish udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. Po ashtu, NjAB me datë 27.04.2021, iu kishte drejtuar me shkresë Ministres aktuale për të njoftuar për planin e punës mirëpo nuk kishte marrë ndonjë përgjigje. Plani ishte aprovuar vetëm nga Komiteti i Auditimit.

Ndërrimet e shpeshta të menaxhmentit ishin shkaktarët e mangësive të lartëcekura.

##### Ndikimi

Kompensimi i zyrtarëve për pozitën që nuk janë në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës ndikon në rritje të pa-arsyeshme të shpenzimeve. Mos aprovimi i planit vjetor të AB-së ka ndikuar në rritjen e numrit të auditimeve me kërkesë.

##### Rekomandimi A6

Ministrja duhet të sigurojë që lëvizjet e personelit të bëhen në harmoni me kriteret profesionale që kërkojnë për përmbushjen e detyrave të caktuara. Po ashtu, plani vjetor i auditimit të brendshëm duhet të aprovohet.

##### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>e</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>29,997,327</b>	<b>28,139,435</b>	<b>22,659,798</b>	<b>24,208,047</b>	<b>29,976,909</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	29,997,327	27,475,745	22,627,926	24,008,621	29,549,830
Donacionet vendore	0	12,591	6,671	0	0
Donacionet e jashtme	0	651,098	25,201	199,426	427,079

Buxheti final është më i ultë se buxheti fillestar për 1,857,892€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2021 Ministria ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 22,659,798€ me një rënie 15% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>29,997,327</b>	<b>28,139,435</b>	<b>22,659,798</b>	<b>24,208,047</b>	<b>29,976,909</b>
Pagat dhe mëditjet	8,438,059	7,090,232	7,089,315	8,076,055	7,761,098
Mallrat dhe shërbimet	17,385,717	18,875,073	14,749,811	15,245,444	20,991,840
Komunalitë	848,551	909,426	524,655	524,684	545,228
Subvencionet dhe transferet	230,000	11,304	8,500	45,670	5,500
Investimet Kapitale	3,095,000	1,253,400	287,517	316,194	673,243


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,347,827€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.11/52 të datës 29.12.2021. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 100%;

- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,489,356€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të qeverisë, rishikimit të buxhetit si dhe kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në kategorinë mallra dhe shërbime ishte 78%;
- Buxheti final për komunalitet krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 60,875€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të qeverisë, rishikimit të buxhetit si dhe kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 58%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 218,696€. Ky zvogëlim ishte rezultat i vendimeve të qeverisë, rishikimit të buxhetit si dhe kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në subvencione dhe transfere ishte 75%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,841,600€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë nr.10/46 të datës 30.11.2021 në vlerë 235,000€ dhe nr.21/50 datë 23.12.2021 në vlerë 1,606,600€. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e investimeve kapitale ishte tepër i ulët 23%. Në këtë nivel të ulët të shpenzimeve kishte ndikuar që projekti i blerjes së ambasadave nuk ishte realizuar fare e që përbënte 45% të buxhetit final, dhe dështimi në blerjen e veturave për administratë dhe ambasada.

Në kuadër të shpenzimeve për menaxhimin e emergjencave për Covid-19 MPJD kishte realizuar shpenzime në vlerë 19,347€ në kategorinë mallra dhe shërbime.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



MPJD për vitin 2021, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 5,871,089€ që krahasuar me vitin paraprak (5,600,096€) kishte një rritje prej 270,993€. Të hyrat realizohen nga taksa për dokumente të udhëtimit, taksa për verifikim të dokumenteve, taksa për letërnjoftim, taksa për shtetësi, taksa për vulë apostile dhe taksa tjera.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>2,863,767</b>	<b>5,817,807</b>	<b>5,871,089</b>	<b>5,600,096</b>	<b>6,170,613</b>
Të hyrat jo tatimore	2,863,767	5,817,807	5,800,262	5,461,178	6,119,742
Të hyrat tjera	0	0	70,828	138,918	50,871

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2020 të MPJD-së ka rezultuar me 12 rekomandime. MPJD kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi Zbatimin e Rekomandimeve 30.09.2021 dhe 15.03.2022, sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tri (3) rekomandime janë zbatuar, shtatë (7) nuk janë adresuar, një (1) pjesërisht i përsëritur, dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

### Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj që në rastin e transfereve të stafit në MDK të ketë një planifikim paraprak për plotësimin e pozitave që lirohen në mënyrë që mos të shkaktohen pengesa në operim si pasojë e mungesës së stafit. Rrjedhimisht, pozita e Zyrtarit të Pasurisë të plotësohet me staf të rregullt dhe të gjitha pasuritë e paregjistruara të regjistrohen në SIMFK.	Mangësi lidhur me regjistrin e pasurive kishte edhe gjatë vitit 2021.	Nuk është adresuar
2.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj që të gjitha pasuritë të regjistrohen në klasat adekuate dhe të bëhet përlogaritja e saktë e zhvlerësimit. Poashtu duhet të merren masa në funksionalizimin e sistemit E-pasuria për regjistrimin e pasurisë nën 1,000€ konform kërkesave ligjore.	Sa i përket zhvlerësimit gjatë vitit 2021 nuk kemi identifikuar gabime, kurse çështja në lidhje me sistemin e-pasuria mbetet e njëjtë ( shih çështjen B2).	I zbatuar
3.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet e raportuara nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore regjistrohen në SIMFK sapo të pranohen nga zyrtarët përgjegjës të MDK-ve dhe të njëjtat raportohen në fund të vitit në RVF si shpenzime totale të ministrisë.	Edhe gjatë vitit 2021 ka shpenzime të pambyllura në vlerë të theksuar.	Nuk është adresuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të ndërmer masa konkrete për të zgjidhur problemin e pozitës së udhëheqësit të divizionit të personelit konform kërkesës ligjore, në mënyrë që të evitohet shpenzime të paarsyeshme për pozitat të cilat tashmë janë të mbuluara me staf të rregullt.	Zv Sekretarja e përgjithëshme me 12.08.2021 ka nxjerr vendim për caktimin e udhëheqësit të Divizionit të burimeve njerëzore për MPJD-në.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të sigurojë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar 30% dhe kontratat të cilat tashmë kanë tejkaluar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë.	Kjo kontratë kishte përfunduar më 21 gusht 2021 dhe MPJD kishte lidhur kontratë të re. Nuk kemi identifikuar tejkalime të 30% nga kontratat tjera kornizë.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të siguroj që, nga MDK-të mbajtja e evidencave të bëhet për secilin automjet zyrtar dhe raportet mujore të dërgohen në divizionin përkatës sipas kërkesave të rregullores në fuqi.	Niveli i raportimit nuk është i duhur ngase një numër shumë i madh i MDK-ve nuk raportojnë fare.	Nuk është adresuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe	Ministrja duhet të rrisë nivelin e mbikëqyrjes ndaj MDK-ve për të siguruar	Në muajin prill të vitit 2021 është aprovuar	Nuk është adresuar

	komunalitë	që ato nuk tejkalojnë limitet e lejuara për mbajtjen e mjeteve në llogaritë bankare përkatëse, në mënyrë që të evitohen potencialisht shpenzimet e paarsyetuara.	kërkesa drejtuar Thesarit për rritje të Limiteve financiare për 19 MDK. Përkundër kësaj mjetet mbi limitin e lejuar nuk janë transferuar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.	
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të ndërmerr masa konkrete në mënyrë që të gjitha avanset të mbyllën duke i respektuar rregulloret në fuqi.	Edhe pse Ministria e Diasporës është fuzionuar me MPJ çështja e avanceve ende nuk është kompletuar. Ndërsa lidhur me ndaljen në paga për pjesën e avanceve të pa arsyetuara MPJD ka filluar zbatimin e rekomandimit.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të ndërmerr masa që në rastet e pagesave për persona tjerë që nuk janë pjesë e MPJD-së, të sigurohet se këto mjete do të kthehen në llogarinë e ministrisë sipas zotimit të përfituesit, në periudhën e caktuar nga ministria.	Edhe këtë vit kishte një rast të tillë. MPJD ka kontaktuar personat përkatës dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve, mirëpo mjetet nuk janë kthyer. MPJD më tutje e ka dërguar këtë çështje në Avokaturën shtetërore.	Nuk është adresuar
10.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministrja duhet të siguroj që raportimi i shpenzimeve nga MDK-të të bëhet në kohë në mënyrë që MPJD të bëjë regjistrimin e shpenzimeve në SIMFK.	Vonesa në raportim kishte edhe në vitin 2021.	Nuk është adresuar
11.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të siguroj që pagesat për shpenzime të bëhen nga kategoria adekuate ekonomike dhe rrjedhimisht gjendja e shpenzimeve të raportohet drejtë në PVF.	Mangësi lidhur me keqklasifikime kishte edhe gjatë vitit 2021.	Nuk është adresuar
12.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të siguroj që në rastin e blerjes së automjeteve për Misionet Diplomatike Konsullore, vlerësimi i markave, llojeve dhe specifikave të automjeteve të bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik.	Edhe këtë vit kishte prokurim lidhur me blerjen e veturave por kjo lëndë nuk ishte subjekt i auditimit pasi që lënda ishte nën hetime	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi

## Letërkonfirmimi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspore -  
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora*

### LETËR E KONFIRMIMIT

**Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021  
dhe për zbatimin e rekomandimeve**

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministritë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës**, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Donika Gërvalla Schwarz

Ministër e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Data: 23.06.2022

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

### (shkëputur nga SNISA 200)

#### Forma e opinionit

##### **Opinioni i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Ambasadën në Vienë në vlerë 17,966€, Ambasadën në Bernë vlerë 7,196€, Ambasadën SHBA në vlerë 6,122€, Ambasadën në Izrael në vlerë 4,570€ dhe blerja e një kompjuteri në vlerë 1,265€ për konsullatën në Danimarkë. 2. MDK në Berlin Suedi, Cyrih, Belgjikë dhe Shtutgart.
- <sup>5</sup> Tajkalimet e drekave ishin: për muajin qershor 3,501€, për muajin korrik 3,676€, dhe për muajin gusht 2,886€.
- <sup>6</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.